



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1800 / 01 Prot.

Datë 27 . 12 .2016

Lënda: Mbi kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Librazhd

Drejtuar: Z. Kastriot GURRA
Kryetar
Bashkia Librazhd

Për dijeni: Bashkimi i Operatorëve ekonomik A&E Engineering shpk dhe Cooprogetti SCRL
Adresa: Rr. Frederik Shiroka, Kulla 1 (ish Fusha e zezë)

I nderuar Z. Gurra,

Në vijim të shkresës Tuaj, Nr. 7024 Prot., datë 09.12.2016, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Territorit me Nr. 1800 Prot., datë 14.12.2016, me lëndë: “Për pajisjen me Aktin e Përputhshmërisë të PPV-së”, dhe botimit të dokumenteve të PPV-së së Bashkisë Librazhd në Regjistrin e Integruar të Territorit, më 15.12.2016, AKPT ka kryer kontrollin e përputhshmërisë sipas legjislacionit të planifikimit dhe atij sektorial.

Në bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, janë shqyrtuar në detaje propozimet për zhvillime në territorin e Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”, pjesë të Bashkisë Librazhd.

Sipas VKM Nr. 640, datë 21.05.2008, “Për shpalljen “Park Kombëtar” të ekosistemit natyror Shebenik-Jabllanicë”, është përcaktuar zonimi i Parkut Kombëtar, i ndarë në katër nënzona ruajtjeje e administrimi:

- a. Zona qendrore (ZQ) – shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar;
- b. Zona e përdorimit të qëndrueshëm (ZPQ) – shkalla e dytë e mbrojtjes;
- c. Zona rekreative (ZR) – shkalla e tretë e mbrojtjes;
- d. Zona e përdorimit tradicional (ZPT) – shkalla e katërt e mbrojtjes, ku ndërtimet mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi.

Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë duhet të qendrojë brenda kornizës së veprimtarive të lejuara nga VKM e shpalljes së Parkut Kombëtar, dhe të respektojë shkallët e mbrojtjes së territorit sipas saj dhe Ligjit për Zonat e Mbrojtura.


Për të qënë në përputhje me këtë legjislacion sektorial, në PPV-në e Bashkisë Librazhd, duhet të reflektohen ndryshimet e mëposhtme në Rregulloren e PPV-së dhe hartën e ndarjet së territorit në njësi:

- **Njësitë 7/64, 7/66 dhe 7/67**, të cilat bëjnë pjesë në dy nënzona të PK njëkohësisht (ZPT dhe ZPQ), duhet të rikonfigurohen për të evituar mbivendosjet e veprimtarive të shkallëve të mbrojtjes, në mënyrë që njësitë të jenë homogjene për sa i përket treguesve zhvillimorë. Pasi të ripërcaktohen kufijtë e tyre, në pjesët që do t'i përkasin ZPT, lejohet sipas legjislacionit ndërtimi i kontrolluar pas pajisjes me leje mjedisore.
- **Njësitë 7/65 dhe 7/68**, si dhe pjesët e **7/64, 7/66 dhe 7/67** në nënzonën ZPQ të parkut, duhet të rishikohen duke respektuar shkallën e dytë të mbrojtjes së këtyre zonave, ku nuk lejohet ndërtimi i zonave urbane. Për të drejtuar zhvillimin e këtyre zonave, nevojitet hartimi i një **Plani të Detajuar të Zonave të Rëndësishme Kombëtare (PDZRK)**, i cili do të përcaktojë treguesit e mundshëm dhe mënyrën e ndërhyrjes në zonë. Pra, PPV për këto njësi nuk mund të japë tregues zhvillimi.
- **Njësitë 3/20, 3/24, 3/60, 3/63, 3/80, 3/81, 3/82, 3/103, 3/104, 3/105, 3/106, 3/107, 3/108, 3/109, 3/110, 3/111, 3/112** bëjnë pjesë në nënzonën ZR, ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, vlen i njëjti përcaktim si më sipër – hartimi i PDZRK për drejtimin e zhvillimit të tyre, dhe mos-shprehja e PPV-së me tregues zhvillimi.
- **Për të gjitha njësitë pjesë të Zonës së Mbrojtur**, në tabelën e njësive në rregullore, duhet shtuar përshkrimi i përkatësisë së njësisë në Parkun Kombëtar (shoqëruar me informacionin për nënzonën që i takon), dhe veprimi i VKM-së përkatëse për menaxhimin dhe zhvillimin e posaçëm të njësisë.

Me reflektimin e këtyre çështjeve, AKPT do të angazhohet për lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë, në mënyrë që të vijohet me miratimin e PPV-së në Këshillin Bashkiak, dhe Këshillin Kombëtar të Territorit.

Me respekt,

Adelina GRECA



DREJTORE E PËRGJITHSHME

Konceptoi, punoi: F.Mali, S. Meta

Datë: 27.12.2016

Nr. Kopje: **3**